



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-351/02-56626
Dt. 20.05.2026
P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e pronarit: **Concordia-Projekte sociale Markus Inama, Bernhard Drumel, Ulla Konrad, Thomas (Hans) Dr. Birtel, Vyrtyt Ibrahimaga** me të cilën ka kërkuar leje për mbindërtimin e objektit- **Qendra për integrim, Socializim dhe Edukim të Komunitetit** në bazë të nenit 3 alineja 1 pikat 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.1 neni 14 alineja 1. Pika 1.1 nenin 15 alineja 1 pika 1.1 , neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 ,si dhe konform neneve 14,15,16,17 dhe 18 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2017 dt. 23.05.2017 , si dhe konform nenit 4 pika 6.1 ,paragrafi 2,dhe paragrafi 14 si dhe pika 6.3 e Rregullores për taksa,tarifa,ngarkesa dhe gjoha nga Shërbimet dhe Veprimtaritë Komunale nr.01/011-46063 dt.28.03.2019 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 27dhe 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 dhe sipas Vendimit për miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Prizrenit (HZK) për periudhën 2022 – 2030 me Nr. 001-011-48192, të datës 31.03.2022, lëshon këtë:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Concordia-Projekte sociale Markus Inama, Bernhard Drumel, Ulla Konrad, Thomas (Hans) Dr. Birtel, Vyrtyt Ibrahimaga		
Adresa:	Prizren		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	Objekti – Mbindertimi i nje pjese të katit të I-rë -Qendra për integrim, Socializim dhe Edukim të Komunitetit
Emri i projektuesit	“Diarko SH.P.K”

Adresa:	Rr.Qazim Berisha H3/1-Prizren		
Telefoni:		Emaili:	

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Concordia-Projekte sociale Markus Inama, Bernhard Drumel, Ulla Konrad, Thomas (Hans) Dr. Birtel, Vyrtyt Ibrahimaga** i lejohet mbindërtimi e një pjese të katit të I-re: **Qendra për integrim, Socializim dhe Edukim të Komunitetit** në ngastrën kadastrale me nr. **P-71813023-00339-47 Zk.Dushanovë.**

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren	
Zonat (t) Kadastrale	<p>Lokacioni i ndërtimit gjendet në Zonën Kadastrale Dushanovë dhe sipas HZK-së është i destinuar ZB-1. Objekti – Mbindërtim i një pjese të katit të I-rë -<u>Qendra për integrim, Socializim dhe Edukim të Komunitetit</u> do të ndërtohet në ngastrën kadastrale me nr . P-71813023-00339-47 Zk.Dushanovë me sipërfaqe sipas kopjes së planit është S=1300 m². Etazhiteti egzistues i pjesës së objektit është: P+0 Etazhiteti i ri i një pjese të objektit do të jetë: P+1</p> <p>Sipërfaqja bruto e katit të I-rë është S=131.76 m². Sipërfaqja neto e katit të I-rë është S=117.60 m².</p> <p>Sipërfaqja bruto e objektit është S=131.76 m². Sipërfaqja neto e objektit është S=117.60 m².</p> <p>Parallogaria e vlerës së objektit sipas dokumentacionit teknik është në shumën prej 108,830.00 €</p>	GPS Koordinatat:

Lirohet nga taksat komunale sipas Rregullores 02/2022 për taksa komunale nr.001-011-99275 dt. 30.06.2022

Lloji i ndërtimit të propozuar: Ndërtimi i ri <input checked="" type="checkbox"/> Rindërtim <input type="checkbox"/> Ripatim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara: Kategoria I <input type="checkbox"/> Kategoria II <input checked="" type="checkbox"/>

A perfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po <input type="checkbox"/> Jo <input checked="" type="checkbox"/>
Perdorimi i propozuar:mbindërtimi i Qendrës për integrim, Socializim dhe Edukim të Komunitetit

Me këtë vendim, poseduesit të lejes **Concordia-Projekte sociale Markus Inama, Bernhard Drumel, Ulla Konrad, Thomas (Hans) Dr. Birtel, Vyrtyt Ibrahimaga** i lejohe mbindërtimi e nje pjese të katit të I-re: **Qendra për integrim, Socializim dhe Edukim të Komunitetit** nga etazhiteti egzistues P+0 në etazhitet **P+1**.

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriatit i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin



apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;

- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproejktuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

Arsyetim

Aplikuesi: **Concordia-Projekte sociale Markus Inama, Bernhard Drumel, Ulla Konrad, Thomas (Hans) Dr. Birtel, Vyrtyt Ibrahimaga** i lejohe mbindërtimi e nje pjese të katit të I-rë: **Qendra për integrim, Socializim dhe Edukim të Komunitetit.**

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:


- Njoftim për plotësim të dokumentacionit .
- Raporti i statikes së objektit
- Pelqimi nga Drejtoria e Emergjences dhe Sigurise.
- Leja Mjedisore Komunale.
- Kater kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-56626 dt: 20.05.2026


Bashkëpunëtor profesional:



Gazmend Berisha, Msc.ndërt



DREJTORI:



Florent Ukaj, ecc.dip.

